

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK

KOMUNAT: GRAÇANICË, MAMUSHË,
SHTËRPECË DHE NOVOBËRDË

2021



RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK

KOMUNAT: GRAÇANICË, MAMUSHË,
SHTËRPCË DHE NOVOBËRDË

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
PËRMBLEDHJE	7
METODOLOGJIA	8
HYRJE.....	9
KOMUNA E GRAÇANICËS	11
Rikonstruimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.....	12
Furnizim me material higjenik – Ritender	15
Rregullimi i shtratit të lumit Graçanka në Graçanicë	16
Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në Graçanicë - Faza I	18
KOMUNA E MAMUSHËS	21
Furnizimi me autoambulancë për QMF-në në Mamushë.....	22
Furnizim me cisternë	24
Furnizim me material shpenzues medicinal për laborator për QMF-në në Mamushë	25
Furnizim me materiale shpenzues higjienik	26
KOMUNA E SHTËRPECËS	27
Furnizim me material higjenik për nevojat e Komunës së Shtërpcës,	
nevojat e shkollave dhe mjekësisë familjare	28
Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit të verës dhe pastrimi i varrezave	29
Furnizim me mjete për mbrojtje nga COVID – 19 për shkollat fillore dhe të mesme	30
Renovimi i shkollave të mesme dhe fillore në territorin e Komunës së Shtërpcës.....	31
KOMUNA E NOVOBËRDËS	33
Asfaltimi i rrugës Stanishor - Strazh	35
Furnizim me dru për ngrohje.....	36
Furnizim me mekanizëm bujqësor dhe multikultivatora për subvencionim të fermerëve.....	38
Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët lokale në Komunën e Novobërdës	38
REKOMANDIME	40

Lista e Shkurtesave

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
OE	Operatori Ekonomik
AK	Autoriteti Kontraktues
LPP	Ligji për Prokurim Publik
KV	Kushtet e Veçanta
TVSh	Tatimi mbi vlerën e shtuar

Përmbledhje

Ky raport i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit përfshin 16 tenderë në katër komuna, atë të Graçanicës, Mamushës, Shtërpcës dhe Novobërdës. Ky është raporti i dytë i monitorimit, ku për secilën komunë janë monitoruar nga katër tenderë, duke filluar nga iniciimi i aktivitetit të prokurimit e deri në zbatim të kontratës.

Nga ky monitorim, D+ ka identifikuar një numër gjetjesh të cilat janë të përbashkëta për këto katër komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristikë e veçantë për secilën komunë. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti janë:

- **Komuna e Graçanicës** nuk ka llogaritur si duhet sigurinë e tenderit dhe atë të ekzekutimit të kontratës. Komuna ka paguar avans për një kompani, shuma e së cilës ka qenë më e lartë se siguria e ekzekutimit, duke vënë komunën në rrezik nëse kontrata nuk do të realizohej si duhet. Po ashtu, është përdorur kontrata kornizë për ndërtim dhe rikonstruim, përderisa ligji e lejon që të përdoret për riparime dhe mirëmbajtje në tenderët për ekzekutim të punëve.
- **Komuna e Mamushës**, ka paraparë kërkesa të panevojshme për tenderë të furnizimeve, siç është plani dinamik dhe kërkesa për referenca të kontratave të përfunduara. Këto sipas interpretimit të KRPP-së nuk duhet të kërkohen për tenderë që kanë të bëjnë me furnizime të produkteve që nuk prodhohen nga operatori ekonomik. Përveç tjerash, komuna vazhdon të pranojë katalogje të shkruara nga vetë kompanitë e që nuk mund të konsiderohen si katalogje zyrtare të prodhuesit.

- **Komuna e Shtërpcës** përmes kriterëve të dosjes së tenderit, shkurtimeve të afatit për të ofertuar, ka bërë që të përshtaten kriteret vetëm për një ofertues të caktuar, i cili edhe e ka fituar kontratën. Në një tender tjetër komuna nuk ka verifikuar fare çmimet e dhëna nga operatori ekonomik. Në dy aktivitetet tjera komuna nuk ka përdorur njësinë e duhur matëse dhe ka përzier artikuj me një pozicion që kanë njësi matëse të ndryshme.
- **Komuna e Novobërdës** vazhdon të përdorë procedurën me poentim, gjë e cila mund të shkaktojë pasiguri te ofertuesit pasi nuk mund t'i dinë paraprakisht sasinë që do të porositen, ndërsa rreziku është që një operator ekonomik (OE) të ketë informata për sasinë që do të porositen dhe të japë kështu çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak. Në një aktivitet tjetër komuna nuk ka marrë parasysh çmimin e kontratës paraprake gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar.

Metodologjia

Në këtë raport janë monitoruar nga katër tenderë për komunat si në vijim: Graçanicë, Shtërpcë, Novobërdë dhe Mamushë. Ky raport është pjesa e dytë e monitorimit të 32 tenderëve, të vitit 2020, për këto katër komuna. Për shkak të situatës së krijuar me pandeminë, është tentuar që së paku një tender për furnizime me mjete mbrojtëse, të jetë pjesë e këtij hulumtimi.

Para përzgjedhjes së tenderëve është bërë një analizë e shkurtër e së paku dhjetë (10) tenderëve për secilën komunë duke analizuar rrezikun në fusha të caktuara, siç janë tenderët për sigurim fizik, furnizim me dru, ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve, blerje të automjeteve, instalim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik. Elemente të tjera që janë marrë për bazë janë çmimet e kontratave të kaluara të të njëjtit autoritet kontraktues si dhe kontratat e autoriteteve të tjera kontraktuese. Për të bërë krahasimin me raportin e parë, janë marrë kontrata të ngjashme dhe kontrata ku janë shfaqur në përgjithësi problemet e njëjta, për të krahasuar se a janë zbatuar rekomandimet e dhëna. Gjatë përzgjedhjes së tenderëve rol të madh ka luajtur eksperiencia katërvjeçare e D+ në monitorimin dhe analizimin e aktiviteteve të prokurimit. Në fund, duke marrë parasysh të gjitha këto elemente së bashku, përzgjedhja është shkurtuar në katër tenderë për secilën komunë.

Pas përzgjedhjes së tenderëve, dokumentet, të cilat komunat janë të obliguara t'i publikojnë, janë marrë nga platforma e-Prokurimi. Këtu përfshihen: njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, dosja e tenderit, vendimi i autoritetit kontraktues, lista e çmimeve dhe kontrata. Pjesa e tjetër e dokumenteve siç janë: procesverbal i hapjes, raporti për vlerësimin e tenderëve, faturat, zotimet dhe urdhërblertjet, raportet e pranimi teknik, si dhe të gjitha ofertat janë kërkuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike. Të gjitha dokumentet që janë kërkuar, janë vënë në dispozicion të D+ nga komunat respektive. Në raport janë të analizuara të gjithë hapat e procesit të prokurimit duke filluar që nga inicimi i aktivitetit të prokurimit, kriteret e dosjes së tenderit, vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e fituesit.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe për shkak se komunat kanë punuar me staf të reduktuar, D+ nuk ka mundur ta bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave në terren.

Hyrje

Kanë kaluar disa vite prej se dorëzimi i ofertave bëhet përmes platformës së e-Prokurimit dhe në këtë drejtim ka përmirësime të vazhdueshme çdo vit. Megjithatë, në pjesët ku ende ka nevojë për faktorin njeri, vërehen çalime të cilat nuk mund të eliminohen në tërësi me sisteme të teknologjisë informative. Shkeljet e vazhdueshme të Ligjit për Prokurim Publik, ligjeve tjera dhe rregulloreve nga zyrtarët e prokurimit dhe ndëshkimet e pakta po shkaktojnë një situatë ku nuk po arrihet qëllimi i LPP-së, për një prokurim efikas dhe ekonomizim. Kjo nënkupton që të merret sa më shumë vlerë me sa më pak para.

Për të ekspozuar shkeljet në prokurim publik, zakonisht janë vetë kompanitë që kanë ofertuar në një tender, ato të cilat i ekspozojnë shkeljet, së pari duke u ankuar te autoriteti kontraktues, e pastaj nëse nuk janë të kënaqura me vendimin, në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OShP). Mirëpo, nëse nuk raportohet ndonjë shkelje nga kompanitë ofertuese atëherë janë organizatat joqeveritare të cilat ekspozojnë shkeljet e ligjit dhe gabimet që bëhen gjatë hartimit të kriterëve të dosjes së tenderit dhe vlerësimit të ofertave.

Nevoja për t'i monitoruar aktivitetet e prokurimit të Komunës së Graçanicës, Mamushës, Shtërpcës dhe Novobërdës ka lindur për shkak të mungesës së monitorimit të hallkës së prokurimit në këto komuna. D+ ka publikuar një raport paraprak për këto komuna, ndërsa ky është raporti i dytë i monitorimit. Ndarja në dy raporte është bërë qëllimshëm, në mënyrë që të krahasohen të gjeturat dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve nga raporti i parë.

D+ angazhohet që përmes monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të prokurimit të nxjerr në pah shkeljet e ligjit, të ekspozojë korrupsionin potencial dhe neglizhencën e zyrtarëve të prokurimit. Në anën tjetër, gjetjet dhe rekomandimet ofrojnë pikë referimi për zyrtarët e prokurimit për t'i evituar kështu shkeljet e dispozitave ligjore në të ardhmen.



Komuna e Graçanicës

Në komunën e Graçanicës janë monitoruar katër aktivitete të prokurimit, tre nga të cilët janë tenderë për punë dhe një për furnizim. Në tenderin për rikonstruimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, komuna ka përdorur kontratën kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajsh, e cila mund të përdoret vetëm kur ka të bëjë me riparime apo mirëmbajtje, ndërsa ky tender është për ndërtim të ri dhe rikonstruim. Komuna ka gabuar në kërkesën për sigurim të ekzekutimit të kontratës, pasi e ka kërkuar më gjatë sesa që është e lejuar me ligj. Gabim tjetër është që në paramasë, e atë në disa pozicione, njësinë matëse e ka shënuar “paushall” dhe sasinë “një”, ndërsa përshkrimi lë të kuptohet që pozicioni do të porositet më shumë se një herë. Komuna ka përzier brenda një paramase, sasitë që i ka ditur me ato që nuk i ka ditur.

Komuna e Graçanicës

Në një aktivitet tjetër të prokurimit komuna ka eliminuar një kompani me arsyetimin se i është shkëputur kontrata paraprake për mosrealizim të saj. Mirëpo, Ligji i Prokurimit Publik nuk parasheh ndëshkim për kompanitë të cilave ju shkëputet kontrata e që të eliminohen nga gara në tenderin vijues. Përveç kësaj, komuna ka kërkuar që kontratat në listë të dëshmohen përmes referencave ose procesverbaleve të pranimit përfundimtar, ndërsa kompania e përzgjedhur si fituese nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që dokumenton përfundimin e kontratës së dorëzuar.

Në tenderin për rregullimin e shtratit të lumit Graçanka në Graçanicë, komuna ka bërë gabime në kërkesat për sigurimin e tenderit dhe sigurimin e ekzekutimit të kontratës. Një gabim tjetër i komunës në të njëjtin tender është se nuk ka kërkuar fare pajisje për një projekt si ky, ndërsa ato janë të domosdoshme.

Në tenderin për ndërtimin e kopshtit për fëmijë në Graçanicë, komuna i ka paguar avans kompanisë fituese, e cila vlerë është më e lartë se siguria e ekzekutimit të kontratës. Në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e kompanisë, komuna është e pambrojtur në këtë mes, e edhe po qe se kompanisë i konfiskohet siguria e ekzekutimit, sërish nuk do të mbulohej shuma e avansit. Për të evituar raste të tilla komuna duhet të kërkojë edhe siguri të avansit, në mënyrë që të ketë në dispozicion një mjet mbrojtës në rast se kontrata nuk zbatohet sipas kushteve të parapara. Komuna këtë aktivitet të prokurimit e ka iniciuar pa e përfshirë në planifikimin e prokurimit për vitin 2020. Gjithashtu, projekti në fjalë nuk gjendet as në buxhetin e vitit 2020.

Rikonstruimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Tenderi për rikonstruimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit u shpall në prill të vitit 2020. Vlera e parashikuar e tenderit ishte 1,100,000 euro, ku ishte përdorur procedura e kontratës kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajsh. Komuna fillimisht kishte shkurtuar afatin kohor për të ofertuar nga 40 ditë sa kërkohet me ligj në 15 ditë, me arsyetimin se ka pasur vonesa në buxhet dhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Ky arsyetim nuk qëndron, e kjo vërtetohet nga veprimi i komunës, e cila një ditë pas shpalljes së tenderit, ka zgjatur afatin e ofertimit nga 15 ditë në 26 ditë.

Në këtë tender ofertuan 14 operatorë ekonomikë, ndërsa kontratën e fitoi konzorciumi i kompanive N.N.T. A.B.C. & Europa Partners Sh.P.K me çmim prej 697,214 euro. Konzorciumi kishte çmimin e dytë më të ulët. Oferta me çmimin më të ulët ishte eliminuar për shkak të gabimeve aritmetikore me tepër se 2% dhe kjo sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP)¹ nuk lejohet. Dy kompani të tjera u eliminuan për shkak që nuk kanë dorëzuar sigurinë e tenderit sipas kërkesës së dosjes së tenderit, ndërsa 10 kompani i plotësuan të gjitha kriteret e kërkuara, por që kishin çmim më të lartë se fituesi i kontratës.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Pevlaku Sh.P.K	1,186,926.60
2.	Alticom Sh.P.K & Benita Company Sh.P.K	863,750.00
3.	Berisha Company Sh.A	752,230.00
4.	N.N.T ABC & Europa Partners Sh.P.K	697,214.00
5.	Beni Construction Sh.P.K & N.P Konaku	702,530.00
6.	Stublla Sh.P.K	826,264.00
7.	BRT Sh.P.K & Joos & Krasniqi-Bazë Sh.P.K	730,030.00
8.	Liqeni VII Sh.A	857,245.00
9.	Company Murseli Sh.P.K& Lulzim Beqiraj B.I	881,223.81
10.	Asfalt Group Sh.P.K & K-Ing Sh.P.K	957,920.00
11.	Kushtrimi NM Sh.P.K & ATC Com Sh.P.K & Vizioni BD Sh.P.K	204,228.10
12.	NNPT Engineering & Gashi Ing Sh.P.K	825,125.50
13.	Alfa I	787,767.00
14.	Alko Impex Sh.P.K & 2T Sh.P.K	905,731.50

Tabela 1: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Rikonstruimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit”

Në përgjithësi kriteret e kërkuar në dosje të tenderit janë në përputhje me natyrën e kontratës, pra nuk ka kërkesa të tepërta që do ta kufizonin konkurrencën. Vlera e qarkullimit financiar në tri vitet e fundit dhe vlera e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit është kërkuar më e ulët se maksimumi i lejuar me ligj dhe kjo ka mundur të ketë ndikuar që të

ketë një numër më të madh të ofertave. Megjithatë, ka disa të meta në kritere, të cilat mund të krijojnë mundësi që të fitojnë kompanitë që nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme për ta ekzekutuar kontratën. Në specifikat teknike janë kërkuar disa pajisje: eskavatorë, bagerë, etj. Pronësia për këto pajisje është kërkuar që të dëshmohet përmes faturave

1 Neni 41.8, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rroopp>.

apo dokumentit unik doganor (DUD). Të dy këto dokumente nuk e dëshmojnë pronësinë aktuale të pajisjes, por vetëm pronësinë e tyre në një kohë të caktuar që e kanë pasur në të kaluarën. Ndërkaq, DUD vetëm tregon se, cila kompani e ka importuar e që mund të mos jetë pronar i tanishëm. Përdërisa komunës i intereson se a i ka në dispozicion kompania pajisjet në momentin e ofertimit, me këto dy dokumente nuk mund të dëshmohet një gjë e tillë dhe krijon mundësinë e keqpërdorimeve.

Gabim tjetër në kriteret është siguria e ekzekutimit. Kohëzgjatja e kontratës është 36 muaj dhe sipas RrUOPP², siguria e ekzekutimit kërkohet për një muaj më tepër, pra 37 muaj, ndërsa komuna e ka kërkuar për 48 muaj. Kjo kërkesë përveç që është në kundërshtim me ligjin, shkakton edhe shpenzime shtesë, e kjo pasi fituesi i kontratës i është dashur që policën e sigurimit ta paguajë më shtrenjtë, gjë që nuk do të ndodhte po të ishte kërkuar vetëm për 37 muaj.

Gabim tjetër është përdorimi i kontratës kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajsh. Kontratat kornizë për punë sipas RrUOPP³ mund të përdoren vetëm kur ka të bëjë me riparime apo mirëmbajtje, gjë që ia mundëson komunës të bëjë vazhdimisht porosi, sa herë të ketë nevojë për riparime. Mirëpo, në këtë tender, sipas titullit dhe paramasës nuk bëhet fjalë për riparim, por për rikonstruim dhe ndërtim të ri. Në tenderët për punë zakonisht dihet sasia e punëve që do të realizohen, përderisa kontrata kornizë mundëson që porositë të bëhen kur lindë një nevojë e tillë. P.sh. një tender për furnizim me ujë është kërkesë e vazhdueshme, pasi që është produkt që konsumohet dhe në momentin që mbaron stoku, porositet sërish. Përderisa punët në ndërtim të ujësjellësit kryhen vetëm një herë dhe nuk ka nevojë që të ketë porosi të reja. Gabimi i njëjtë është evidentuar edhe në raportin e parë⁴, ku vërehet që komuna nuk i ka marrë parasysh rekomandimet që Demokraci Plus kishte dhënë në këtë drejtim.

2 Neni 30.6, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rruopp>
3 Po aty, neni 56.2.
4 Komuna të vogla, probleme të mëdha, Demokraci Plus. 2020. <https://dplus.org/ep-content/uploads/2020/07/2020-07-Komuna-te-vogla-probleme-te-medha-ne-prokurim-ALB.pdf>
5 Neni 18.3, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rruopp>
6 Po aty, neni 56.10.

Kushtet e Veçanta (KV) të dosjes së tenderit nuk janë kërkuar me rastin e publikimit të tenderit. Ky veprim bie ndesh me RrUOPP⁵, sipas të cilit këto kushte duhet që të përgatiten së bashku me dosjen e tenderit. Mosspecifikimi i tyre mund të shpie në situatë ku disa operatorë ekonomikë të jenë të favorizuar nëse i dinë kushtet paraprakisht. Në këto kushte specifikohet garancioni për produktet, i cili ndikon në çmimin që do ta ofrojë operatori ekonomik. Elemente të tjera që specifikohen në KV janë afati për të filluar punimet, menaxheri i kontratës si dhe më e rëndësishmja, se cili organ është përgjegjës në rast se ka mosmarrëveshje mes palëve.

Një e metë tjetër është mënyra se si është ndërtuar paramasa. Në këtë rast, komuna ka përdorur kontratën kornizë, sipas së cilës lejohet që pozicionet dhe totali i kontratës të ketë mospërputhje për plus/minus 30%. Mirëpo, komuna në disa pozicione sasinë e ka dhënë në formë të paushallit dhe ka caktuar sasinë “një”, por nga përshkrimi i pozicioneve kuptohet që i njëjti pozicion do të porositet disa herë e jo vetëm njëherë. Për ta ilustruar këtë, në pozicionin 1.6 është kërkuar që “*Dëmtimet dhe riparimet e instalimeve nëntokësore të cilat gjenden në rrugën e rrjetit të kanalizimit*”, ku sasia e dhënë është 1 dhe njësia matëse paushall. Sipas përshkrimit, kuptohet se mund të ketë më shumë se një prishje dhe nënkuptohet se çdo prishje që mund të ndodhë do të riparohet. Mirëpo sipas dispozitave të RrUOPP⁶, mospërputhja prej plus/minus 30% vlen për çdo pozicion të paramasës. Në këtë rast, komuna mund ta rrisë sasinë për 30% e cila do të bëhej 1.3, por nuk do të kishte ndonjë efekt gjatë zbatimit meqë edhe ashtu nuk mund të bëhen 1.3 riparime, por vetëm 1. Komuna brenda një paramase, i ka përfshirë sasitë që i ka ditur me ato që nuk i ka ditur. Kur nuk dihet sasia, atëherë duhet të përdoret procedura me çmim për njësi. Në formën se si është ndërtuar paramasa, komuna do ta ketë të vështirë zbatimit e kontratës pa e shkelur ligjin, sidomos për pozicionet ku sasia është 1.

Furnizim me material higjenik – Ritender

Ky aktivitet i prokurimit është ritender i një tenderi paraprak, pasi për të parin kontrata ishte shkëputur për faj të operatorit ekonomik, Olti & Kenza, pasi i njëjti nuk i kishte dërguar produktet brenda afatit të paraparë. Në tenderin e dytë, fitues u shpall kompania P.P. Olymp me çmim 9,775.29 euro. Në këtë tender kishte ofertuar edhe kompania Olti & Kenza, e cila ishte eliminuar për shkak që kontrata e parë i ishte shkëpu-

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Olti & Kenza Sh.P.K.	9,036.40
2.	P.P. Olymp	9,775.29
3.	N.T.P. A&B Market	8,747.80

Tabela 2: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material higjenik – Ritender”

Pasi ky aktivitet i prokurimit është me vlerë të vogël, komuna nuk ka kërkuar kriteret të tepërta. I vetmi kriter është që kompania fituese të ketë kontrata të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit në vlerë prej 10,000 eurove dhe që afati për dorëzim të mallit të jetë pesë ditë pas pranimit të porosisë. Kompania fituese ka dorëzuar deklaratën se do ta kryejë furnizimin brenda pesë ditësh, por për kërkesën që të ketë projekte të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit, kompania ka dorëzuar vetëm një listë me një kontratë që ka vlerën 11,400 euro. Komuna ka kërkuar që kontratat në listë të dëshmohen përmes referencave ose procesverbaleve të pranimit përfundimtar, ndërsa kompania fituese nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që e dëshmon që kontrata përkatëse është realizuar. Komuna është dashur të kërkojë sqarime para se të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës, t’i japë kohë kompanisë që të dorëzojë referencë për kon-

7 Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

tur. Edhe pse qëllimi i komunës mund të shihet si veprim i duhur, që mos të lejohet të fitojë kontratë një kompani të cilës i është shkëputur kontrata, nuk ka bazë ligjore që të merret një veprim i tillë. Ligji i Prokurimit Publik nuk parasheh ndëshkim për kompanitë të cilave ju shkëputet kontrata, në këtë rast që të eliminohen nga gara në tenderin vijues.

Kompania tjetër, A&B Market është eliminuar me të drejtë, pasi nuk ka dorëzuar referenca për kontrata të realizuara në vlerë prej 10,000 euro.

tratën në fjalë dhe nëse do ta dorëzonte atëherë mund të nënshkruhej kontrata. Me këtë veprim komuna nuk ka pasur garanci të mjaftueshme se kompania ka përfunduar kontrata të ngjashme në të kaluarën. Komuna ka shkelur nenin 59 të LPP-së, pasi nuk ka bërë vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në specifikat teknike në disa pjesë janë përmendur emra të produkteve. Për shembull, në pozicionin 60 janë kërkuar pelena Active Baby, e që është emër marke. LPP e ndalon që specifikat teknike të përshtaten për një markë të caktuar, përveç në raste të caktuara kur nuk është e mundur ndryshe, mirëpo duhet që të shtohet fjala “e barasvlershme” ose “ekuivalente”, e që në këtë rast nuk është shtuar as kjo fjalë⁷.

Rregullimi i shtratit të lumit Graçanka në Graçanicë

Një tender i njëjtë që përfshinte rregullim të shtretërve të lumenjve është nënshkruar në vitin 2020. Në atë tender fitues i kontratës është përzgjedhur kompania N.N.T A.B.C &

Europa Partners Sh.P.K me çmim 2,996,324 euro. Edhe tenderi me emërtimin “Rregullimi i shtratit të lumit Graçanka në Graçanicë” është fituar nga kompania N.N.T A.B.C së bashku me kompaninë N.N.T. Bini Sh.P.K me çmim prej 127,892.50 euro. Për shkak që tenderi i parë nuk pasur projekt ekzekutiv të publikuar nuk dihet nëse bëhet fjalë për të njëjtën projekt.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Eurofamis SH.A	142,375.90
2.	Vizioni BD Sh.P.K. & Kushtrimi NM Sh.P.K.	167,544.30
3.	Mirusha Company Sh.P.K.	193,026.78
4.	Sinani Ing Sh.P.K.	139,011.50
5.	N.N.T. ABC & N.N.T Bini Sh.P.K.	127,892.50
6.	Ridvan Elezi B.I.	149,388.56
7.	Arhiko.ING & Arbëri-NS Sh.P.K.	214,710.68
8.	Alfa I	141,722.40

Tabela 3: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i shtratit të lumit Graçanka në Graçanicë”

Nga tabela më lartë shihet se komuna i ka dhënë kontratën ofertuesit më të lirë. Asnjë nga kompanitë tjera nuk është cilësuar si e papërgjegjshme, pasi sipas komunës të gjitha kanë plotësuar kriteret e kërkuar, por nuk kanë fituar kontratën për shkak të çmimit më të lartë.

Në kriteret e tenderit, komuna përsëri ka gabuar me kërkesën për sigurim të ekzekutimit të kontratës. Përdërisa kontrata është paraparë të përfundojë për pesë muaj, siguria e ekze-

kutimit është kërkuar për 17 muaj. Kjo bie ndesh me dispozitat ligjore dhe shkakton shpenzime shtesë për kompaninë. Nëse komuna ka dashur që të përfshijë në sigurim të ekzekutimit edhe periudhën garantuese, atëherë kjo nuk është mënyra më e mirë për ta kërkuar. Garancioni për punët kërkohet në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Gabim tjetër i komunës është edhe kërkesa për sigurim të tenderit. Vlera e kërkuar e sigurimit të tenderit ka tejkaluar limitin ligjor. Në dosje, sigurimi i tenderit është kërkuar që të jetë 5,000 euro, mirëpo në bazë të RrUOPP⁸-së, kjo shumë duhet të jetë ndërmjet 1 deri në 3% të vlerës së parashikuar të tenderit:

Vlera e parashikuar
166,000 euro * 0.03 (maksimumi 3%) = 4,980 euro

Për sigurinë e tenderit duhet të paguhet policë sigurimi dhe pasi vlera e kërkuar është më e lartë se ajo që është parashikuar sipas ligjit janë shkaktuar shpenzime shtesë për tetë kompanitë që kanë marrë pjesë në këtë tender. Dallimi prej 20 eurosh mund të duket i vogël, por duke u bazuar edhe në të gjeturat nga raporti i kaluar, ky gabim ka ndodhur përsëri dhe ka shkaktuar shpenzime shtesë për ofertuesit.

Komuna nuk ka kërkuar fare pajisje për realizimin e këtij projekti. Sipas RrUOPP⁹, autoriteti kontraktues në dosje të tenderit duhet të deklarojë të gjitha kriteret dhe informatat relevante për aktivitetin e prokurimit. Rehabilimi i shtratit të lumit nuk mund të bëhet pa pajisje. Dëshmi për këtë janë fotografitë që ka publikuar faqja zyrtare e komunës në Facebook, e ku shihen pajisjet në prapavijë. Me këtë veprim komuna ka hapur rrugën që edhe kompanitë që nuk kanë pajisje fare të ofertojnë. Varësisht nga numri i pajisjeve që kërkohen për një projekt ka edhe ndikim në çmim, pasi pajisjet ose duhet të blihen ose të merren me qera. Të dyja këto kanë kosto për ofertuesit, ndërsa rreziku është që të krijohet avantazh për kompaninë që e ka fituar kontratën e njëjtë në vitin 2018. E probleme mund të lindin edhe gjatë zbatimit të kontratës, pasi kompania mund të deklarohet se do të angazhojë vetëm një numër të caktuar të pajisjeve.

“
NË KRITERET E TENDERIT, KOMUNA PËRSËRI KA GABUAR ME KËRKESËN PËR SIGURIM TË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS. PËRDERISA KONTRATA ËSHTË PARAPARË TË PËRFUNDOJË PËR PESË MUAJ, SIGURIA E EKZEKUTIMIT ËSHTË KËRKUAR PËR 17 MUAJ.

8 Neni 29.4, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rruopp>
9 Po aty, neni 18.4.

Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në Graçanicë - Faza I

Në tenderin për ndërtimin e kopshtit për fëmijë ofertuan 13 kompani, ndërsa tenderin e fitoi kompania N.N.T ABC me

çmimin më të ulët, prej 275,470.29 euro. Të gjitha ofertat tjera u cilësuan si të pasuksesshme për shkak të çmimit më të lartë në krahasim me ofertën e fituesit.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Pro & Co Group SH.P.K & FlorinG Sh.P.K.	378,845.49
2.	Euro Project Sh.P.K	328,757.97
3.	N.N.T ABC	275,470.29
4.	H&B Consulting Sh.P.K	328,407.01
5.	Kompania Prishtina Sh.P.K	344,222.00
6.	Arhiko.ING	349,349.34
7.	Hysen Sopa B.I & Euro Group Sh.P.K	324,950.12
8.	Beni Construction Sh.P.K	322,536.60
9.	Mercom Company Sh.P.K	349,625.02
10.	AC ing Sh.P.K	292,755.86
11.	MEL Engineering Sh.P.K & Interling Constuction Sh.P.K	340,129.99
12.	Engrup Sh.P.K	302,432.47
13.	Alko Impex	388,516.90

Tabela 4: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në Graçanicë - Faza I”

Edhe në këtë tender, njëjtë si në tenderin për rregullim të shtratit të lumit komuna ka kërkuar sigurinë e ekzekutimit të tenderit për 17 muaj në vlerë 10% të vlerës së kontratës. Mirëpo kohëzgjatja e kontratës është për pesë muaj, ndërsa siguria e ekzekutimit është dashur të kërkohej për gjashtë muaj. Komuna për tenderët që shpall në të ardhmen duhet që sigurinë e ekzekutimit ta kërkojë në përputhje me LPP.

Komuna me rastin e nënshkrimit të kontratës i ka paguar avans kompanisë në vlerë prej 41,320.54 euro apo 15% të vlerës së kontratës, ndërsa siguria e ekzekutimit është 27,547.10 euro. Siguria e ekzekutimit kërkohej në mënyrë që komuna të ketë një mjet mbrojtës në dispozicion në rast se kompania nuk zbaton kontratën siç duhet dhe mund ta konfiskojë në tërësi. Mirëpo në këtë rast avansi i dhënë është më i lartë se siguria e ekzekutimit. Me këtë veprim komuna ka marrë përsipër një rrezik të madh dhe në rast se kontrata nuk zbatohet si duhet, e edhe po qe se konfiskohet siguria e ekzekutimit, komuna sërish del në humbje. Për të evituar raste të tilla komuna duhet të kërkojë edhe siguri të avansit, në mënyrë që të ketë në dispozicion një mjet mbrojtës në rast se kontrata nuk zbatohet sipas kushteve të parapara.

Komuna këtë aktivitet të prokurimit e ka iniciuar pa e vendosur fillimisht në plan të prokurimit. Përveç kësaj, nuk është përfshirë në buxhet të vitit 2020¹⁰. Inicimi i aktiviteteve të prokurimit pa u siguruar së pari se ka buxhet, paraqet rrezik të madh për komunën me pasoja të mëdha në rast të mospagesave. I vetmi dokument ku përmendet ky projekt është në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022, por buxheti është shumë më i ulët, 150,000 euro, ndërsa kontrata është nënshkruar për 275,470.29 euro.

10 Ligji nr. 07L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

“
NË TENDERIN PËR NDËRTIMIN E KOPSHTIT PËR FËMIJË OFERTUAN 13 KOMPANI, NDËRSA TENDERIN E FITOI KOMPANIA N.N.T ABC ME ÇMIMIN MË TË ULËT, PREJ 275,470.29 EURO. TË GJITHA OFERTAT TJERA U CILËSUAN SI TË PASUKSESSHME PËR SHKAK TË ÇMIMIT MË TË LARTË NË KRAHASIM ME OFERTËN E FITUESIT.



Komuna e Mamushës

Në komunën e Mamushës janë monitoruar katër aktivitete të prokurimit, ku të gjitha janë kontrata të furnizimeve. Tenderi për furnizim me autoambulancë për QMF-në është anuluar pasi asnjë nga operatorët ekonomik nuk ka plotësuar kriteret. Në tenderin e dytë, komuna ka kërkuar plan dinamik, kërkesë e cila është e panevojshme, meqë obligimi ka qenë që të dorëzohet vetëm një produkt. Në dosje të tenderit është kërkuar katalogu, por komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar fare a përputhet katalogu me specifikat e kërkuara, pasi ka dallime në mes të katalogut të prodhuesit në faqen zyrtare në internet dhe atij të dorëzuar nga fituesi i kontratës. Gjithashtu katalogu është dorëzuar në një nga gjuhët që nuk janë zyrtare në Kosovë.

Komuna e Mamushës

Në tenderin për furnizim me një cisternë, komuna ka kërkuar që ofertuesi të dorëzojë dëshmi se ka përfunduar me sukses tri kontrata për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit. Sipas RrUOPP¹¹ dhe interpretimit nga KRPP¹² është e panevojshme dhe joprofesionale të aplikohen kërkesat për kontrata të realizuar në tri vitet e fundit (kërkesa që burojnë nga neni 69 i LPP), për furnizime të cilat nuk prodhohen nga ofertuesi i tyre dhe nuk janë të ndonjë rëndësie të veçantë.

Në dosjen e tenderit komuna ka kërkuar që ofertuesi të hartojë dhe dorëzojë planin dinamik (afati i liferimit) në ditë kalendarike sipas specifikave teknike. Fituesi i kontratës, Agri Bau nuk ka dorëzuar plan dinamik, por vetëm një deklaratë të liferimit se do të dërgojë cisternën brenda 30 ditëve nga marrja e porosisë. Komuna ka paraparë se në rast se ofertuesit nuk e përmbushin këtë kusht, oferta do të refuzohet.

Në tenderin për furnizim me material shpenzues higjienik, komuna ka kërkuar plan dinamik, gjë e cila është e panevojshme kur ka të bëjë me furnizime të zakonshme. Pavarësisht kësaj, fituesi i kontratës nuk ka dorëzuar plan dinamik, por vetëm një deklaratë liferimi. Për shkak të gabimeve teknike në paramasë, ku kanë qenë disa produkte të përsëritura nga dy herë në pozicione të ndryshme, komuna ka ndryshuar dy herë paramasën dhe ka fshirë nga e njëjta produktet që ishin të listuara dy herë, mirëpo nuk ka korrigjuar edhe vlerën e parashikuar të tenderit për të reflektuar ndryshimet në sasi.

Veprimet pozitive të Komunës së Mamushës janë te pjesa e kushteve të veçanta, ku janë kërkuar së bashku me dosjen e tenderit. Gjithashtu të gjitha aktivitetet e prokurimit janë të listuara edhe në planin e prokurimit për vitin 2020.

Furnizimi me autoambulancë për QMF-në në Mamushë

Për këtë aktivitet të prokurimit komuna dy herë ka shpallur tender. Tenderi i parë është anuluar pasi të dy ofertat që ishin dorëzuar u shpallën të papërgjegjshme për shkak që nuk kishin ofruar autoambulancë në bazë të specifikave teknike. Në tenderin e dytë përsëri ofertuan dy kompani, ndërsa fitues u shpall kompania Mercom me çmim 38,340 euro, ndërsa çmimi i kompanisë tjetër, Profitech, ishte 44,800 euro e cila njëkohësisht tejkalonte buxhetin e komunës i cili ishte 40,000 euro.

Arsyet që kanë shtyrë në anulimin e tenderit të parë kanë të bëjnë me specifikat teknike të autoambulancës. Në një nga kriteret është kërkuar që harxhimet e automjetit të jenë 5.3 litra për 100 km, për një motor me 135 kuajfuqi (KF) dhe 2.3 ccm. Në tenderin e dytë komuna e ka përmirësuar këtë kërkesë dhe ka kërkuar që shpenzimet mesatare të jenë maksimum 7.5 l / 100 km, ndërsa fuqia e motorit të jetë 130 KF.

Në kriteret e dosjes së tenderit është një kërkesë e cila nuk përshtatet me llojin e aktivitetit të prokurimit. Komuna ka kërkuar që ofertuesit të dorëzojnë plan dinamik (afat liferimi) në ditë sipas specifikave teknike. Pasi lloji i tenderit është furnizim dhe vetëm një pajisje do të liferohet, atëherë nuk ka kuptim që të kërkohet plani dinamik e sidomos kur ofertuesit e kanë pasur afatin e dhënë në dosje të tenderit. Komuna ka kërkuar që dorëzimi i autoambulancës duhet të ndodhë brenda 40 ditë nga data e porosisë. Në këtë rast nuk do të duhej të kërkohet plani dinamik pasi është kërkesë e panevojshme. Pasi janë analizuar kërkesat në disa tenderë të Komunës së Mamushës, vërehet se kjo kërkesë është standarde, por duhet që komuna ta konsiderojë që ta heqë kur bëhet fjalë për furnizime. Arsyeimi i komunës është se kërkesa për plan

dinamik (afat liferimi) mund të plotësohet me një deklaratë të thjeshtë liferimi. Kjo nuk është e saktë pasi plan dinamik i hartuar në ditë dallon nga një deklaratë e thjeshtë liferimi. Për të larguar paqartësitë komuna duhet ta qartësojë kërkesën më shumë ose planin dinamik ta kërkojë vetëm në tender për punë ndërsa deklaratë për afat liferimi ta kërkojë për tender për furnizime.

Komuna ka kërkuar katalog me specifika teknike të cilat duhet të përshtaten me ato të kërkuara në dosje të tenderit. Kompania Mercom ka dorëzuar një katalog në gjuhën frënge, ndërsa sipas LPP dokumentet duhet të dorëzohen në një nga gjuhët zyrtare (shqip, serbisht dhe anglisht). Komuna gjithashtu e ka çekur në dosje si kërkesë se katalogu duhet të dorëzohet në një nga gjuhët zyrtare. Siç duket komisioni i vlerësimit fare nuk e ka pasur parasysh këtë kërkesë pasi ka pranuar pa vërejtje katalogun në gjuhën frënge. Komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar fare a përputhet katalogu me specifikat e kërkuara. Me këtë veprim komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar tenderët në bazë të nenit 59.4 të LPP-së i cili thotë se tenderët duhet të vlerësohen në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 13.4 i cili thotë se dokumentet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Kompania Mercom ka dorëzuar edhe një dokument tjetër të cilin e ka emërtuar “Oferta me specifika teknike”. Në këtë dokument kompania ka listuar specifikat teknike të autoambulancës Peugeot Boxer L4H2 2.2, por që nuk mund të merret si katalog zyrtar pasi është shkruar nga vetë kompania. Për shembull në katalogun zyrtar mungon e dhëna sa i përket shpenzimeve të autoambulancës për 100 km, por në katalogun e shkruar është kjo e dhënë. Kompania në katalogun e vet ka shënuar se shpenzimet mesatare janë 6.0 l / 100 km, mirëpo katalogu zyrtar prej faqes së prodhuesit thotë se shpenzimet janë 6.2 l / 100 km¹³. Në këtë rast kërkesa është plotësuar edhe pse është shënuar 6.0, mirëpo, siç është theksuar në raportin e kaluar¹⁴, në rast se komuna pranon katalogje të shkruara nga vetë kompanitë, ekziston rreziku që të dhënat të mos jenë të



ARSYET QË KANË SHTRYRË NË ANULIMIN E TENDERIT TË PARË KANË TË BËJNË ME SPECIFIKAT TEKNIKE TË AUTOAMBULANCËS. NË NJË NGA KRITERET ËSHTË KËRKUAR QË HARXHIMET E AUTOMJETIT TË JENË 5.3 LITRA PËR 100 KM, PËR NJË MOTOR ME 135 KUAJFUQI (KF) DHE 2.3 CCM. NË TENDERIN E DYTË KOMUNA E KA PËRMIRËSUAR KËTË KËRKESË DHE KA KËRKUAR QË SHPENZIMET MESATARE TË JENË MAKSIMUM 7.5 L / 100 KM, NDËRSA FUQIA E MOTORIT TË JETË 130 KF.

sakta. Në rastin e këtij tenderi, pasi katalogu i prodhuesit nuk përmban shumë të dhëna, komuna është dashur që përmes kërkesës për sqarime shtesë, të kërkojë nga Mercom që të dëshmojë se autoambulanca Peugeot Boxer L4H2 2.2 i ka të gjitha specifikat e kërkuara. Në të njëjtën kohë komuna është dashur që të kërkojë përmes kërkesës për sqarim që katalogu të ofrohet në njërën nga gjuhët zyrtare.

Veprim i mirë i komunës është parashtrimi i kërkesave në Kushtet e Veçanta të dosjes së tenderit në momentin e publikimit të tenderit e jo siç ka vepruar Komuna e Graçanicës kur ato i ka parashtruar vetëm kur është nënshkruar kontrata. KV për këtë tender janë mjaft të detajuara dhe me kriteret të qarta.

11 Neni 26.8, faqe 65, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rroopp>
12 Pyetjet e shpeshta nr. 57, KRPP, 2017. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=268>

13 Peugeot Boxer Brochure <https://media.peugeot.fr/file/99/2/peugeot-boxer-spec-sheet-january-2018-ëeb.pdf?lcdv16=2PU91DHDP670A0C0>
14 Komuna të vogla, probleme të mëdha. Demokraci Plus. 2020. <https://dplus.org/ëp-content/uploads/2020/07/2020-07-Komuna-te-vogla-probleme-te-medha-ne-prokurim-ALB.pdf>

Furnizim me cisternë

Tenderi për furnizim me një cisternë për spërkatje dhe larje të rrugëve u publikua në maj të vitit 2020 me vlerë të parashikuar prej 16,000 euro. Në këtë tender ofertuan dy kompani ku fitues u zgjodh kompania Agri Bau me çmim 15,300 euro, ndërsa ofertuesi tjetër ishte N.P.T Haxhijaha me çmim 100 euro më të lartë, 15,400 euro.

Edhe pse tenderi është për një furnizim të thjeshtë, në kriteret e dosjes së tenderit është një kriter i panevojshëm që kanë mundur ta kufizojnë konkurrencën. Komuna ka kërkuar që ofertuesi të dorëzojë dëshmi se ka përfundura me sukses tri kontrata për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit. Sipas RRUOPP¹⁵ dhe interpretimit nga KRPP¹⁶ është e panevojshme dhe joprofesionale të aplikohen kërkesat për kontrata të realizuara në tri vitet e fundit (kërkesa që burojnë nga neni 69 i LPP-së) për furnizime të cilat nuk prodhohen nga ofertuesi i tyre dhe nuk janë të ndonjë rëndësie të veçantë. Në këtë rast blerja e një cisterne uji nuk është e ndonjë rëndësie të veçantë e gjithashtu nuk prodhohet nga asnjëri nga dy ofertuesit e këtij tenderi. Edhe pse këtë kriter e kanë plotësuar të dy ofertuesit, po të mos kërkoheshin tri referenca ka mundur që të rritet konkurrenca. Veprimi i komunës ka bazë në ligj, mirëpo siç e ka theksuar KRPP duhet pasur parasysh edhe disa praktika të mira të cilat shtojnë gjasat që të ketë më shumë konkurrenca e në fund të merret më shumë vlerë për para:

“KRPP ka vërejtur se shume AK i aplikojnë ato (kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 te LPP-se) edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevoë për tu dëshmuar. (P.sh.: për aktivitetet te cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e te cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kriterëve nga neni 68 dhe/ose 69 nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund te shkaktoj probleme te panevojshme.”

15 Neni 26.8, faqe 65, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019. <https://dpl.us/rruopp>

16 Pyetjet e Shpeshta nr. 57. KRPP, 2017. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=268>



TENDERI PËR FURNIZIM ME NJË CISTERNË PËR SPËRKATJE DHE LARJE TË RRUGËVE U PUBLIKUA NË MAJ TË VITIT 2020 ME VLERË TË PARASHIKUAR PREJ 16,000 EURO. NË KËTË TENDER OFERTUAN DY KOMPANI KU FITUES U ZGJODH KOMPANIA AGRI BAU ME ÇMIM 15,300 EURO, NDËRSA OFERTUESI TJETËR ISHTE N.P.T HAXHIJAHA ME ÇMIM 100 EURO MË TË LARTË, 15,400 EURO.

Një e metë tjetër e kërkesave në dosje të tenderit është se cisterna është kërkuar të dëshmohet përmes fotografisë e cila duhet të përmbajë specifikat teknike të cilat i përshtaten atyre të kërkuara në dosje të tenderit. Së pari fotografia si e vetme nuk dëshmon asgjë rreth specifikave dhe së dyti formulimi i kërkesës ka bërë që të dy ofertuesit të dorëzojnë fotografi me specifika që janë fjalë për fjalë të njëjta me specifikat e kërkuara. Komuna nuk ka mundur të kërkojë katalog, pasi për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, KRPP ka vendosur së kërkesa për katalogje është e palejuar. Një nga kërkesat ka qenë që cisterna të ketë kapacitet prej 10,000 litrave. Në bazë të fotografive që Agri Bau ka dorëzuar, në njërën shkruan dhjetë (10) ton e në tjetrën tetë (8) ton. Fotografitë që ka dorëzuar Haxhijaha nuk

mund të shihen mirë pasi janë pa ngjyra. Komisioni i vlerësimit në momentin e vlerësimit të ofertave nuk ka mundur ta dijë se a kanë ofruar të dy kompanitë sipas specifikave të kërkuara. Nuk ka ndonjë dëshmi se komuna e ka verifikuar se a ka ofertuar Agribau cisternë dhjetë (10) apo tetë (8) ton.

Në dosjen e tenderit komuna ka kërkuar që ofertuesi të hartojë dhe dorëzojë planin dinamik (afati i liferimit) në ditë kalendarike sipas specifikave teknike. Në rast se ofertuesit nuk e përmbushin këtë kusht, komuna shprehimisht e ka cekur se oferta do të refuzohet. Fituesi i kontratës, Agri Bau nuk ka dorëzuar plan dinamik, por vetëm një deklaratë të liferimit se do të dërgojë cisternën brenda 30 ditëve nga marrja e porosisë. Në vetvete dokumenti i dorëzuar nga kompania mund të merret që i plotëson kriterin pasi nuk ka kuptim të kërkohet plan dinamik në ditë kalendarike kur bëhet fjalë për vetëm një produkt. Plani dinamik në ditë kalendarike ka kuptim, për shembull në tenderët e rrugëve ku me të drejtë autoriteti kontraktues ka nevojë të dijë për mbarëvajtjen e punëve. Komuna ka anashkaluar kriterin e vendosur pasi ka pranuar deklaratë liferimi si ekuivalente të një plani dinamik. Plani dinamik dhe deklarata e liferimit edhe pse mund të duken të njëjta, ato dallojnë. Përderisa deklarata e liferimit është vetëm një deklaratë e thjeshtë, plani dinamik është diçka më tepër, e kur paraqitet në ditë kalendarike plani se si do të realizohet kontrata. Në mënyrë që mos të përsëriten gabime të tilla, komuna duhet ta shqyrtojë mundësinë që kërkesën për plan dinamik mos ta kërkojë kur bëhet fjalë për furnizime të thjeshta të vetëm një produkti.

Veprim i mirë i komunës është parashtrimi i kërkesave në Kushtet e Veçanta të dosjes së tenderit në momentin e publikimit të tenderit e jo siç ka vepruar Komuna e Graçanicës kur ato i ka parashtruar vetëm kur është nënshkruar kontrata. KV për këtë tender janë mjaft të detajuara dhe me kriteretë qarta.

Furnizim me material shpenzues medicinal për laborator për QMF-në në Mamushë

Në tenderin për furnizim me material shpenzues medicinal ofertuan vetëm dy kompani, Konti SH.P.K me çmim 11,751 euro dhe Interlab SH.P.K me çmim 15,320.80 euro. Fituesi i kontratës u zgjodh kompania Konti, ndërsa Interlab u cilësua si ofertë e pasuksesshme për shkak të çmimi më të lartë. Kontrata është e tipit kontratë kornizë për një kohëzgjatje prej 12 muajsh. Nga monitorimi i këtij aktiviteti të prokurimit, D+ ka ardhur në përfundim se nuk ka asnjë gjetje që mund të cilësohet shkelje ligjore. Për më tepër komuna ka përdorur procedurën e hapur, kur shumë autoritete tjera kontraktuese, duke shfrytëzuar situatën me pandeminë kanë lidhur kontrata duke përdorur procedurën pa publikim të njoftimit për kontratë.

Aktiviteti i prokurimit ka qenë i planifikuar, pasi gjenden në Planin e Prokurimit për vitin 2020 si dhe të gjitha pagesat janë bërë në përputhje me Rregullën Financiare 01/2013. Kushtet e Veçanta janë specifikuar së bashku me dosjen e tenderit dhe kontrata është publikuar në e-Prokurim, dukë përfshirë dhe listën e çmimeve apo pjesën financiare.

Furnizim me materiale shpenzues higjienik

Në tenderin për furnizim me material shpenzues higjienik kishin ofertur katër kompani. Kontratën ishte fituar nga

ofertuesi me çmimin më të lirë, përkatësisht kompania El Shpëtimi me çmim 3,044.80 euro. Një kompani tjetër kishte çmim më të lartë, ndërsa dy të tjera u eliminuan.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Dauti Komerc shpk & Dauti Komerc AD	3,759.56
2.	N.T El Shpëtimi	3,044.80
3.	Shaip Mustafa B.I	3,502.40
4.	N.T.SH. Gipa	3,868.30

Tabela 5: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me materiale shpenzues higjienik”

Për kompaninë Shaip Mustafa B.I. dhe N.T.SH Gipa, një nga arsyet e eliminimit kanë qenë kanë qenë mosdorëzimi ip-lanit dinamik. Siç është përmendur në tenderët më lartë, kërkesa për plan dinamik kur ka të bëjë më furnizime është e panevojshme dhe ka mundësi që është kërkesë standarde në të gjitha dosjet e tenderit të publikuar nga Komuna e Mamushës. Mirëpo as kompania El Shpëtimi nuk ka dorëzuar plan dinamik, por vetëm një deklaratë liferimi.

Në kritere të dosjes së tenderit, janë kërkuar që ofertuesit të kenë tri referenca për kontrata të ngjashme gjatë tri viteve të fundit. Marrë parasysh që vlera e parashikuar për këtë tender është vetëm 4,800 euro, duke marrë parasysh që është prokurim për furnizim të mallrave që janë të zakonshme dhe gjenden në shumë markete në Kosovë, duke marrë parasysh interpretimin e KRPP-së të përmendur më lartë, atëherë kërkesa e komunës është e tepërt dhe nuk është në përputhje me natyrën e kontratës. Nuk është njëjtë si të kërkohen tri referenca për një tender të vogël e me furnizime të zakonshme krahasuar me një projekt ndërtimit e ku kërkohet nivel eksperience më i lartë.

Për shkak të gabimeve teknike në paramasë, ku kanë qenë disa produkte të përsëritura nga dy herë në pozicione të ndryshme, autoriteti kontraktues ka ndryshuar dy herë paramasën dhe ka fshirë nga paramasa produktet që ishin të listuara dy herë. Gjithashtu me këto përmirësime ka zgjatur afatin për ofertim. Edhe pse janë hequr disa produkte nga paramasa, komuna nuk ka bërë edhe njëherë llogaritjen e vlerës së parashikuar. Kur është publikuar tenderi me vlerë të parashikuar prej 4,800 euro ka qenë paramasa fillestare me 39 artikuj, ndërsa paramasa e korrigjuar me të cilën është nënshkruar kontrata ka 33 artikuj. Në paramasën origjinale sasia totale e të gjithë artikujve është 5,227, ndërsa në paramasën finale, sasia është 4,442. Komuna është dashur ta korigjojë vlerën e parashikuar, pasi vlera ka mbetur e njëjtë ndërsa sasia totale e artikujve ka ndryshuar. Kjo ka mundur që të keqpërdoret nga ofertuesit që të japin çmim më të lartë për tender, pasi vlera e parashikuar jo e korrigjuar do të ua mundësonte këtë. Gjithmonë kur shtohen ose hiqen artikujt nga paramasa, kjo duhet të reflektohet edhe në vlerën e parashikuar, pasi kjo vlerë llogaritet në bazë të numrit të artikujve dhe sasive që kërkohen në paramasë.



Komuna e Shtërpçës

Në komunën e Shtërpçës janë monitoruar katër tenderë, dy për punë dhe dy për furnizime. Në tenderin për furnizim me material higjenik në disa artikuj ka përmendur emra të produkteve, gjë e cila ndalohet sipas LPP-së dhe në disa artikuj nuk ka përdorur njësitë e duhura matëse.

Rast i njëjtë është edhe në tenderin për mirëmbajtje të rrugëve lokale gjatë sezonit të verës, ku në disa pozicione të paramasës nuk janë përdorur njësitë matëse të duhura dhe në një pozicion janë përzier dy shërbime që kanë njësi matëse të ndryshme.

Komuna e Shtërpcës

Në tendërin për furnizim me mjete për mbrojtje nga COVID – 19, komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka verifikuar çmimet, në të cilat vërehet dallimi me TVSH. Komuna është dashur të korrigjojë normën e TVSH-së e pastaj të lidhë kontratën.

Në tenderin për renovimin e shkollave të mesme janë evidencuar shkeljet më të mëdha. Komuna përmes kritereve të dosjes së tenderit, shkurtimit të afatit për të ofertuar, ka bërë që të përshtaten kriteret vetëm për një ofertues të caktuar, i cili edhe e ka fituar kontratën. Me këto veprime komuna nuk ka arritur që të pranojë vlerën për paratë e shpenzuara.

Komuna e Shtërpcës nuk ka zbatuar rekomandimet e raportit të kaluar, pasi ende vazhdon që mos t’i publikojë pjesën financiare

të kontratës dhe kushtet e veçanta, e të cilat nuk i specifikon në dosje të tenderit, por i cakton pasi të nënshkruhet kontrata.

Furnizim me material higjienik për nevojat e Komunës së Shtërpcës, nevojat e shkollave dhe mjekësisë familjare

Tenderi për furnizim me material higjienik është i tipit të kontratës standarde për një periudhë prej një viti me vlerë të parashikuar prej 13,410 euro. Në këtë tender ofertuan nëntë kompani, ndërsa fitues u zgjodh Beni Dona Plast, me çmim 8,166 euro, i cili ishte njëkohësisht edhe çmimi më i ulët krahasuar me ofertat tjera.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Olti & Kenza	10,000.46
2.	Lanti Plast Sh.P.K	9,051.50
3.	Dauti Komerc & Dauti Komerc AD	12,154.95
4.	NTSH Tradita Tregtare	9,874.50
5.	Beni Dona Plast	8,166.00
6.	Teknika Sh.P.K	10,867.50
7.	NT El Shpëtimi	9,271.50
8.	Shaip Mustafa B.I	9,932.50
9.	PM Group Sh.P.K	8,601.00

Tabela 6: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material higjienik për nevojat e Komunës së Shtërpcës, nevojat e shkollave dhe mjekësisë familjare”

Komuna ka bërë disa shkelje procedurale gjatë procesit. Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar në platformën e e-Prokurimit, mirëpo nuk ka përfshirë në të letrat standarde për ofertuesin fitues, ata të pasuksesshëm dhe të eliminuar, siç kërkohet nga neni 43.2 i RrUOPP¹⁷. Shkelje tjetër është mospublikimi i pjesës financiare së bashku me kontratën. Kjo e gjetur është theksuar edhe në raportin e kaluar të monitorimit, mirëpo siç duket komuna nuk ka marrë veprime për ta përmirësuar gabimin. Publikimi i pjesës financiare apo listët së çmimeve kërkohet sipas nenit 22.3f të RrUOPP. Lista e çmimeve është elementi kryesor që iu intereson palëve të interesit, meqë gjenden çmimet që ka ofruar fituesi për çdo artikull. Shkelje tjetër është mosspecifikimi i KV-së në dosje të tenderit me rastin e publikimit të tenderit. Ky veprim bindesh me RrUOPP¹⁸, sipas së cilit të njëjtat kushte duhet që të përgatiten së bashku me dosjen e tenderit. Mosspecifikimi i tyre mund të shpie në situatë ku disa operatorë ekonomik të jenë në avantazh nëse i dinë kushtet paraprakisht. Në këto kushte specifikohet garancioni për produktet, i cili ndikon në çmimin që do ta ofrojë operatori ekonomik. Elemente të tjera që specifikohen në KV janë afati për të filluar punimet, menaxheri i kontratës, si dhe më e rëndësishmja, se cili organ është përgjegjës në rast se ka mosmarrëveshje.

Në paramasë komuna në disa pozicione ka përmendur emra të markave tregtare, gjë e cila është e ndaluar. LPP e ndalon që specifikat teknike të përshtaten për një markë të caktuar, përveç në raste të caktuara kur nuk është e mundur, mirëpo duhet që të shtohet fjala “e barasvlershme” ose “ekuivalente”, gjë që në këtë rast përgjithësisht është respektuar nga ana e komunës¹⁹. Komuna në disa pozicione ka vendosur fjalën “e ngjashme”, por në disa të tjera jo. Në pozicionin 3, ka kërkuar produktin Vim i lëngët, ku emri “Vim” është emri i një produkti në treg. Tjetër gabim është se të gjithë artikujt janë kërkuar me njësi matëse “kom/copë” që nënkupton komplet ose copë. Por për disa produkte dallon shumë kompleti dhe copa. Për shembull një komplet i letrës së tualetit mund të ketë brenda saj 10 copë. Me këtë veprim, komuna i ka dhënë

mundësinë dhe të drejtën kompanisë fituese që të zgjedhë të dërgojë një komplet apo vetëm një copë.

Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit të verës dhe pastrimi i varrezave

Në tenderin për mirëmbajtje të rrugëve lokale gjatë sezonit të verës dhe pastrimi i varrezave ka ofertuar vetëm një kompani, e cila edhe fitoi kontratën. Vlera e parashikuar e tenderit ka qenë 8,000 euro, ndërsa Vera Sh.P.K fitoi kontratën me çmim prej 7,794 eurosh. Për shkak që tenderi është me vlerë të vogël, kompanitë nuk kanë qenë të interesuar të marrin pjesë, edhe pse komuna nuk ka aplikuar fare kriteret. Nuk ka kërkuar as referenca për kontrata të përfunduara e as pajisje.

Megjithatë, probleme ka pasur në hartimin e paramasës, e cila ka mundur të përpilohet më mirë duke mos lënë kështu mundësi e as hapësirë për keqpërdorime potenciale. Në pozicionin e parë është kërkuar “kositja dhe bartja e barit rreth rrugës” me sasi 500 km. Mirëpo, jo çdo kilometër e rrugës ka bari përreth që duhet të kositet dhe të bartet. Komuna duhet të ketë kujdes gjatë ekzekutimit të kontratës, pasi kompania mund ta faturojë edhe kositjen dhe bartjen e barit për një rrugë që ka 30 kilometra, por që mund të mos ketë bar përgjatë gjithë këtyre 30 kilometrave.

Në pozicionin e dytë është kërkuar “mbledhja dhe bartja e mbeturinave rreth rrugës, si dhe mbledhja e mbeturinave nëpër varreza duke i llogaritur edhe qeset për mbeturina” me sasi 500 km. Problemi është se janë përzier dy shërbime të ndryshme që njësinë matëse e kanë të ndryshme. Përderisa mbledhja e mbeturinave në rrugë mund të matet me kilometra, mbledhja e mbeturinave në varreza nuk matet me kilometra, por me metër katrorë ose me hektarë, siç e ka dhënë komuna njësinë matëse në pozicionin shtatë. Përzierja e dy shërbimeve të ndryshme në një pozicion mund të shka-

17 Neni 43.2, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019. <https://dpl.us/rruopp>
18 Po aty, neni 18.3.
19 Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

ktijë probleme gjatë ekzekutimit të kontratës. Pyetja është se, nëse kompania mbledh mbeturina në varreza atëherë sa kilometra do ta faturojë shërbimin? Kjo është e pamundur të dihet me këtë njësi matëse, e cila e krijon mundësinë që të ketë keqpërdorime.

Në pozicionin e gjashtë është kërkuar “largimi i drunjëve që janë rritur rreth rrugës” me sasi 100 orë. Edhe në këtë pozicion njësi matëse është e gabuar pasi është dashur që të përdoret njësi “copë” në mënyrë që të dihet saktë se sa dru do të largohen. Njësi matëse me orë i krijon mundësinë kompanisë që të punojë shumë ngadalë në mënyrë që të ecin orët dhe të largojë sa më pak drunjë për një orë. Përdorimi i njësisë matëse “copë” do ta mbronte komunën dhe do të sigurohej që një numër i caktuar i drunjëve do të largohen. Për të marrë si krahasim, në pozicionin e shtatë ku është kërkuar largimi i barit të vogël nga varrezat, njësi matëse është hektari e jo ora.

Nga shtatë pozicione, shihet se në tre prej tyre ka probleme thelbësore përmes së cilave komuna nuk merr vlerë për para. Nëse krahasohet paramasa e të njëjtit tender të vitit 2019, pozicionet janë të njëjta me përshkrime të njëjta vetëm se sasia është shumë më e vogël. Për shembull pozicioni shtatë që është për largim të barit të vogël nga varrezat, sasia në tenderin e vitit 2019 ka qenë 52 hektarë, ndërsa në atë të vitit 2020, 78 hektarë. Nuk ka mundësi që brenda një viti të rritet kaq shumë sipërfaqja e varrezave, me ç'rast kjo tregon që hartimi i paramasës ka probleme.

Pasi që vlera e tenderit është e vogël, komuna nuk ka mundësi që të përdorë kontratën kornizë dhe të ketë mundësi që të devijojë sasi të për plus/minus 30%. Në tenderët për mirëmbajtje të rrugëve është shumë vështirë që të parashikohet sasia e saktë, prandaj përdoret kontrata kornizë. Komuna duhet që ta shqyrtojë mundësinë që të shpallë tenderin e ardhshëm duke përdorur kontratën kornizë, e atë për një periudhë 24 ose 36 muaj. Për të evituar problemet në paramasë duhet që të përdoret njësi matëse e duhur duke shikuar edhe praktikatat e autoriteteve tjera kontraktuese për tenderë të ngjashëm.

Furnizim me mjete për mbrojtje nga COVID – 19 për shkollat fillore dhe të mesme

Për shkak të shfaqjes së pandemisë COVID-19, komunat janë detyruar që të shpenzojnë nga buxheti i tyre për të blerë mjete mbrojtëse. Një tender i tillë është për blerje të maskave dhe dezinfektuesve për duar për shkollat fillore dhe të mesme. Pasi komuna nuk kishte vendosur shumë kritere, një numër i madh kompanish kishin ofertuar po ashtu (gjithsej 17 oferta). Kontratën e fitoi kompania Again LTD me çmim më të ulët, 5,496 euro. Komuna ofertat tjera i cilësoi si të papërgjegjshme për shkak se kishin çmim më të lartë, por është dashur që të cilësohen si të pasuksesshme pasi të njëjtat i kanë plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit dhe nuk kanë dhënë çmim më të lartë se vlera e parashikuar.

Agani ka gabuar gjatë plotësimit të paramasës, ku në pozicionin tre, për furnizim me maska njëpërdorimshme ka dhënë çmimin 2,000 euro, ndërsa është dashur të jetë 1,000 euro pasi sasia është 10,000 dhe çmimi 0.10 euro për copë. Ky gabim është përmirësuar kur është nënshkruar kontrata, pasi në këtë rast vlen çmimi për njësi i cili ka qenë në rregull por vetëm është bërë gabim gjatë llogaritjes dhe nuk mund të cilësohet si gabim aritmetikor.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk ka vërejtur gabimet me normën e TVSh-së. Në paramasë janë vetëm tri pozicione në tërësi dhe ka mundur shumë lehtë të bëhet llogaritja.

● Në pozicionin një – dezinfektues për duar, sasia e dhënë, 800 litra, çmimi pa TVSh 2.64 euro, TVSh 18%, ndërsa çmimi me TVSh 3.12 euro. Mirëpo, $2.64 * 1.18 = 3.115$. Meqë, LPP nuk lejon që të rrumbullakohen numrat dhe sipas dosjes së tenderit merren parasysh vetëm dy numra pas pikës dhjetore atëherë çmimi për njësi me TVSh duhet të jetë 3.11 euro. Pasi çmimi lëviz për një cent (3.12 – 3.11) kur të shumëzohet ky numër me sasinë 800 litra, diferenca është tetë euro.

● Në pozicionin dy – maska njëpërdorimshme për fëmijë, sasia e dhënë 20,000 copë, çmimi pa TVSh 0.08 euro, TVSh 18%, ndërsa çmimi me TVSh 0.10 euro. Mirëpo, 0.08

* $1.18\% = 0.0944$ dhe pasi që nuk mund të rrumbullakohet numri dhe nuk lejohen më shumë se dy numra pas pikës dhjetore, çmimi bëhet 0.09 euro. Diferenca pasi të përmirësohet çmimi është 200 euro.

● Në pozicionin tre – maska njëpërdorimshme për të rritur, sasia e dhënë 10,000 copë, çmimi pa TVSh 0.08 euro, TVSh 18%, ndërsa çmimi me TVSh 0.10 euro. Megjithatë, $0.08 * 1.18\% = 0.0944$ dhe pasi që nuk mund të rrumbullakohet numri dhe nuk lejohen më shumë se dy numra pas pikës dhjetore çmimi bëhet 0.09 euro. Diferenca kur të përmirësohet çmimi është 200 euro.

Në tërësi, për shkak që nuk është verifikuar llogaritja e çmimeve, dallimi është 408 euro, dhe pasi ka ndodhur me normë të TVSh-së, komuna është dashur ta përmirësojë çmimin pa e pyetur kompaninë. Si rezultat komuna do të paguajë 408 euro më shumë për shkak që nuk është verifikuar norma e TVSH-së.

Në mënyrë që gabime të tilla mos të ndodhin në të ardhmen, komuna duhet që të ndërtojë paramasën në Excel dhe të shfrytëzojë llogaritjet me formula. Excel-i mundëson që mos të ndodhin gabime në llogaritje apo neglizhencë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit, të cilët nuk kanë llogaritur fare çmimet.

Renovimi i shkollave të mesme dhe fillore në territorin e Komunës së Shtërpçës

Tenderi për renovim të shkollave është publikuar më 18 shtator 2020, me vlerë të parashikuar prej 267,272 euro dhe me afat prej tre muajsh për t'i përfunduar punët. Në këtë tender ofertoj vetëm një konsorcium, Euro Infrastruktura & NSH Besa me çmim 264,125.90 euro, e cila edhe fitoi kontratën. Vlera e kontratës është sa 98.8% e vlerës së parashikuar. Komuna përmes kërkesave në dosje të tenderit në mënyrë

20 PN Certificate.
<https://ëëë.pkn.pl/en/services/certification/pn-certificate>
21 Neni 20.6, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019.
<https://dpl.us/rrop>

të hapur ka krijuar kushte që tenderin në fjalë ta fitojë vetëm fituesi i kontratës.

Në dosje të tenderit janë tri kërkesa, të cilat D+, që katër vite e gjysmë monitorimi, e me qindra tenderë të analizuar nuk ka hasur në asnjë të tillë. Kërkesa e parë është që të dorëzohet certifikatë e konformitetit me standardin PN-EN 62208:2011. Së pari, ky standard ka të bëjë me tension të ulët dhe montim të pajisjeve të kontrollit dhe shikuar nga pozicionet e paramasës dhe çmimet e dhëna, vlera totale e punimeve për elektrikë është 35,459 euro apo 13.4% e çmimi të kontratës. Së dyti, PN-EN 62208:2011 është standard i shtetit të Polonisë²⁰, dhe sipas RrUOPP²¹ është e ndaluar që të kërkohej standarde të shteteve tjera, përveç atyre evropiane ose të Kosovës që implementojnë një standard evropian. Dhe së fundi, komuna nuk e ka specifikuar fare se për çfarë produkti kërkon certifikatë konformiteti, e cila kërkohet për të vërtetuar se një produkt i caktuar është testuar konform një standardi të caktuar.

Kërkesa e dytë është që të dorëzohet certifikatë e kalibrit nga laborator i për energji dhe njehsorë të energjisë (energy & PowerMeter). Edhe kjo kërkesë është e panevojshme, pasi në paramasë askund nuk përmendet montimi i njehsorëve. Kërkesa e tretë është që të dorëzohet certifikatë valide e qëndrueshmërisë së performancës CE (EN 40-5:2002), si dhe të jetë e bashkangjitur certifikata e karakteristikave të produkteve dhe a-testet e konformitetit. Njëjtë si në kërkesën e dytë, as këtu nuk është specifikuar se për cilin produkt është kërkuar certifikata e qëndrueshmërisë. Të tri këto kërkesa nuk kanë të bëjnë me natyrën e kontratës, pasi siç është shpjeguar më lartë punët në elektrikë përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të të gjitha punëve.

Kur të tri kërkesave më lart i shtohet edhe shkurtimi i kohës për të dorëzuar ofertat me arsyen se projekti duhet të përfundojë para përfundimit të vitit fiskal, atëherë përshtatja e kritereve për vetëm një ofertues bëhet edhe më e theksuar. Sipas njoftimit për kontratë, projekti duhet të përfundojë brenda 60

ditëve, ndërsa kontrata është nënshkruar më 21.10.2020. Po të përdorej afati i rregullt për dorëzim të ofertave, nënshkrimi i kontratës do të shtyhej edhe për 10 ditë të tjera, dhe prapë do të përfundonte brenda vitit fiskal, e për më tepër që publikimi i tenderit mund të bëhej shumë më herët. Shkurtimi i afatit nga 20 ditë në 10, nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme operatorëve që të mund të pajisen me certifikata të tilla edhe po të dëshiro- nin të merrnin pjesë në tender.

Gjatë fazës së dorëzimit të ofertave, një kompani ka bërë pyetje rreth kriterëve. Komuna nuk e ka marrë parasysh këtë pyetje dhe nuk e ka publikuar pyetjen fare në e-Prokurim, ashtu siç është e detyrur ta bëjë²².

Edhe pse kriteret janë përshtatur për konsorciumin Euro Infrastruktura & NSh Besa, dokumentet e dorëzuara nuk janë sipas kërkesave në dosje të tenderit. Certifikata e kon- formitetit PN-EN 62208:2011 është kërkuar në emër të ofertuesit ose autorizim nga kompania e cila posedon këtë certifikatë. NSh Besa ka dorëzuar certifikatën e konformite- tit të kompanisë Incobex Sp. z.o.o., ndërsa ka dorëzuar au- torizim nga kompania Rade Koncar Kontaktori i Relei e cila është e autorizuar nga kompania Smelt Ing doo, e cila pastaj përmes një deklarate thotë se është e autorizuar nga Inco- box Sp. z.o.o. Nga kërkesa e dosjes së tenderit kuptohet se certifikata ka mundur të jetë në emër të ofertuesit ose të ketë autorizim nga një kompani e cila e ka certifikatën. NSh Besa nuk ka autorizim nga Incobex Sp. z.o.o dhe prandaj nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit. Autorizimet nuk mund të barten në tri kompani të ndryshme, siç ka vepru- ar NSh Besa. Kjo mund të vërtetohet edhe nga një vendim i Organit Shqyrtues të Prokurimit për të njëjtën çështje²³. Edhe po të lejohej bartja e autorizimit në tri kompani pa le- jen eksplicite të prodhuesit, nga dokumentet e dorëzuara të NSh Besa prapë se prapë nuk mund të pranohet si kërkesë e plotësuar, meqë kompania Smelt Ing doo nuk ka dorëzuar autorizim nga Incobex Sp. z.o.o, por një deklaratë të shkruar nga vetë kompania, përmes të cilës thuhet se është e autor- izuar nga Incobex Sp. z.o.o.

Në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë e kalibrimit nga laborator i për energji dhe njëhsorë të energjisë (energy & PowerMeter). Si dëshmi është kërkuar kopje e certifikatës së kalibrimit nga laborator i, origjinal në emër të ofertuesit ose autorizim nga kompania e cila e ka këtë certifikatë. As kjo kërkesë nuk është plotësuar, pasi konsorciumi ka dorëzuar certifikatën e prodhuesit Control Applications Ltd, por e cila ka lëshuar autorizim për kompaninë Rade Koncar Kontak- tori i Relei, e cila nuk ka ofertuar në këtë tender. Pra, sipas kësaj, mungon autorizimi nga Rade Koncar Kontaktori i Relei për konsorciumin, i cili edhe po të ekzistonte përbën bartje të paautorizuar të autorizimit në një tjetër kompani. Prob- lemi tjetër është se certifikatën e kalibrimit e ka lëshuar vetë prodhuesi për vetveten, e praktika është që testimi të bëhet nga një palë e tretë, në mënyrë që testimi të jetë i besue- shëm.

Për shkak se komuna ka përshtatur kriteret për vetëm një ofertues, përmes kriterëve të dosjes dhe shkurtimit të afatit për ofertim ka bërë që çmimi i ofertës të jetë shumë afër vlerës së parashikuar. Po të mos përshtateshin kriteret, do të rritej konkurrenca e si pasojë, çmimi i kontratës ka mundur të jetë shumë më i ulët. Por, siç duket, interesi i komunës nuk ka qenë që të kursehen paratë e taksapaguesve, por të shpërblehet një operator ekonomik i caktuar me kontratë.



Komuna e Novobërdës

Në Komunën e Novobërdës janë analizuar katër tenderë, ku dy janë për punë dhe dy për furnizime. Në tenderin për asfaltimin e rrugës Stanishor – Strazh, ofertuesi i parë, i cili ishte rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk kishte dorëzuar vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), vërtetim ky që dëshmon që i njëjti nuk ka borxhe. Komuna vazhdoi me ofertuesin e dytë, mirëpo nuk ka dëshmi se ka konfiskuar sigurinë e tenderit dhe se ka bërë kërkesë në OShP që kompanitë Dar Ing Sh.P.K & NNSh Co-Ing të diskualifikohen.

22 Po aty, neni 25.
23 Vendimi 256-261/18, Organi Shqyrtues i Prokurimit, 2018.
<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/256-261-18vend.pdf>

Komuna e Novobërdës

Në Komunën e Novobërdës janë analizuar katër tenderë, ku dy janë për punë dhe dy për furnizime. Në tenderin për asfaltimin e rrugës Stanishor – Strazh, ofertuesi i parë, i cili ishte rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk kishte dorëzuar vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), vërtetim ky që dëshmon që i njëjti nuk ka borxhe. Komuna vazhdoi me ofertuesin e dytë, mirëpo nuk ka dëshmi se ka konfiskuar sigurinë e tenderit dhe se ka bërë kërkesë në OShP që kompanitë Dar Ing Sh.P.K & NNSh Co-Ing të diskualifikohen.

Në tenderin për furnizim me dru, gjatë inicimit të procedurës së prokurimit, komuna nuk ka marrë parasysh çmimin e kontratës paraprake gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar. Si pasojë ka nënshkruar kontratë mbi vlerën e parashikuar. Meqë koha kur është publikuar tenderi ka qenë sezona e verës, komuna ka mundur ta anulojë tenderin dhe ta shpallë sërish, me ç’rast drutë do mund të bliheshin me çmim më të ulët.

Në tenderin për furnizim me mekanizëm bujqësor është përdorur procedura me poentim, edhe pse kanë mundur të dihen sasi të sakta të produkteve. Përdorimi i kësaj procedure kur mund të dihen sasi të është e ndaluar. Përdorimi i procedurës me poentim mund të shkaktojë pasiguri te ofertuesit pasi nuk mund t’i dinë paraprakisht sasinë që do të porositen. Një rrezik tjetër është që një operator ekonomik të ketë informata për sasi që do të porositen dhe të japë çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak. Sipas përvojës së D+ në monitorim të prokurimit publik, kjo gjë ka ndodhur mjaft shpesh.

Në anën tjetër, në tenderin “Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët lokale”, komuna ka zbatuar rekomandimet e D+ nga raporti i parë, duke mos përdorur procedurën me poentim të çmimeve.



NË TENDERIN PËR FURNIZIM ME DRU, GJATË INICIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, KOMUNA NUK KA MARRË PARASYSH ÇMIMIN E KONTRATËS PARAPRAKE GJATË PËRCAKTIMIT TË VLERËS SË PARASHIKUAR. SI PASOJË KA NËNSHKRUAR KONTRATË MBI VLERËN E PARASHIKUAR. MEQË KOHA KUR ËSHTË PUBLIKUAR TENDERI KA QENË SEZONA E VERËS, KOMUNA KA MUNDUR TA ANULOJË TENDERIN DHE TA SHPALLË SËRISH, ME Ç’RAST DRUTË DO MUND TË BLIHESHIN ME ÇMIM MË TË ULËT.

Asfaltimi i rrugës Stanishor – Strazh

Në tenderin për asfaltimin e rrugës Stanishor – Strazh kishin ofertuar 12 kompani. Vlera e parashikuar e tenderit ka qenë

95,000 euro. Fituesi i kontratës ishte zgjedhur grupi i operatorëve ekonomik Dua Arch Sh.P.K & Pro&Co Group Sh.P.K me çmim 79,935.50 euro.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Dua Arch Sh.P.K & Pro&Co Group Sh.P.K	79,935.50
2.	Rahovica Commerce Sh.P.K	82,075.50
3.	Afrim Beka B.I & Bashkimi Mali Sh.P.K	82,857.00
4.	NNP Art Projekt & Gashi Ing Sh.P.K	84,582.70
5.	Quality Asphalt Sh.P.K & Mirusha Company Sh.P.K	85,925.50
6.	Eko Group Sh.P.K & Lirigzoni S Sh.P.K	87,102.00
7.	Globus Construcion-S Sh.P.K & Burimi-E	88,293.00
8.	Zuka Commerce Sh.P.K	89,593.00
9.	Rexha Sh.P.K	94,505.00
10.	Varna Sh.P.K	94,520.80
11.	Bejta Commerce SH.A	110,686.46
12.	Dar Ing Sh.P.K & NNSh Co-Ing	78,804.53

Tabela 7: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës Stanishor –Strazh”

Operatori ekonomik me çmimin më të lirë, Dar Ing Sh.P.K & NNSh Co-Ing, fillimisht është shpallur fitues, mirëpo ka dështuar që të dorëzojë dokumentet e kërkuar për kërkesat e përshtatshmërisë. Këto dokumente përfshijnë vërtetimin nga gjykata, vërtetimin nga ATK-ja që dëshmon që kompanitë

nuk kanë borxhe dhe vërtetim të pagesë së tatimit në pronë. Komuna i ka dhënë afat pesë ditë kompanive që t’i dorëzojnë këto dokumente, por ato nuk janë përgjigjur. Pas kësaj komuna ka vazhduar dhe i ka dhënë kontratën operatorit ekonomik me çmimin e dytë më të ulët.

Një nga veprimet më të shpeshta për kurdije të tenderit është kur operatori ekonomik i shpallur fitues dështon të dorëzojë dokumentet që kërkohen para nënshkrimit të kontratës. Kjo i hap rrugë që operatori me çmim më të lartë të fitojë kontratën. Sipas RrUOPP²⁴, nëse një ofertues është zgjedhur fitues, mirëpo dështon t'i dorëzojë dokumentet e kërkuara, atëherë vazhdohet me ofertuesin e dytë, mirëpo autoriteti kontraktues (AK) duhet që të konfiskojë sigurinë e tenderit si dhe të iniciojë procedurën për diskualifikimin e OE sipas nenit 99.2 të LPP-së. Diskualifikimi mund të zgjasë deri në një vit, gjatë të cilës kohë OE nuk ka të drejtë të marrë pjesë në tenderë. Këtë vendim e merr Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas kërkesës që paraqet AK-ja. Në këtë tender është kërkuar siguria e tenderit në vlerë prej 1,000 euro. Komuna është dashur që ta konfiskojë këtë shumë në përputhje me RrUOPP dhe gjithashtu të bëjë kërkesë në OShP që kompanitë Dar Ing Sh.P.K & NNSh Co-Ing të diskualifikohen. Ekziston gjithmonë rreziku për marrëveshje të fshehta kur kompanitë që zgjidhen fituese tërhiqen ose nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara para nënshkrimit të kontratës. Për shkak që autoriteti kontraktues e ka të pamundur që marrëveshjen e fshehtë ta zbulojë para ofertimit, atëherë të vetmet mekanizma mbrojtës sipas ligjit janë konfiskimi i sigurisë së tenderit dhe kërkesa për diskualifikim të operatorëve ekonomik.

Për këtë kontratë është nënshkruar edhe një aneks kontratë në vlerë prej 7,992.40 euro e cila është sa 10% e çmimit të kontratës, pra në limitin që e lejon ligji. Mirëpo, arsyet pse është dashur që të lidhet aneks kontrata nuk janë bindëse. Tenderi duhet të hartohet në atë mënyrë që mos të ketë nevojë për aneks kontrata. Një operator ekonomik mund të ketë informacione se për një tender do të ketë aneks kontratë dhe të ofrojë çmim më të ulët në tender dhe ta mbulojë diferencën në çmim përmes aneks kontratës. Ky është një rrezik që përballen çdo herë autoritetet kontraktuese, sa herë që ka aneks kontrata.

Furnizim me dru për ngrohje

Në tenderin për furnizim me dru kanë ofertuar dy kompani, Aome Sh.P.K me çmim 30,750 euro dhe Wood Company Sh.P.K me çmim 25,237.50 euro. Fitues është zgjedhur Aome Sh.P.K, ndërsa Wood Company ishte eliminuar për shkak që nuk kishte dorëzuar librezat e qarkullimit me validitet për njërin kamion. Edhe pse komuna i ka dhënë mundësi që të sqarojë tenderin dhe i ka dhënë afat pesë ditë për të dorëzuar librezën me validitet, kompania nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Vlera e parashikuar e tenderit është 26,000 euro dhe siç mund të vërehet nga çmimet e dy ofertuesve, kontrata është nënshkruar duke tejkaluar buxhetin e paraparë. Kjo lejohet sipas nenit 62 të LPP-së, mirëpo për të kursyer buxhetin komuna është dashur të anulojë tenderin dhe ta rishpallë përsëri për këto arsye:

- Tenderi është iniciuar në qershor të vitit 2020, pra në kohën kur drutë nuk janë të nevojshme. Komuna ka shpallë tenderin në kohën e përshtatshme në mënyrë që të marrë çmim më të mirë.
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues është publikuar më 6 gusht 2020. Përmes këtij vendimi, komuna ka mundur ta anulojë tenderin për arsye se Wood Company është eliminuar dhe Aome Sh.P.K ka tejkaluar vlerën e parashikuar.
- Komuna ka mundur ta ritenderojë menjëherë në muajin gusht, me ç'rast do të kishte kohë të mjaftueshme për të pranuar ofertat, t'i vlerësonte ato dhe të nënshkruante kontratë me fituesin, e atë deri nga fundi i muajit shtator.
- Komuna ka parashikuar që një metër kub dru, së bashku me prerjen e tyre, ta blejë për 34.67 euro (26,000 euro vlera e parashikuar / 750 sasia), ndërsa me kontratën e nënshkruar do të paguajë 41 euro (40 euro çmimi i një metri dru dhe 1 euro çmimi për prerjen e tyre).

- Në kontratën paraprake të vitit 2019, komuna ka paguar 33.80 euro për një metër dru së bashku me prerjen e tyre.

Po të kishte parasysh komuna të gjitha arsyet e cekura më lart, atëherë do të kursehej buxheti i komunës, pra nëse tenderi do të anulohet dhe të rishpallej. Me vlerën e njëjtë të parashikuar, komuna do të mund të nënshkruante kontratë me çmim rreth 34 euro, duke kursyer shtatë euro për një metër kub (41 – 34) apo 5,250 euro (7 * 750).

Gjatë inicimit të procedurës së prokurimit, komuna nuk ka marrë parasysh çmimin e kontratës paraprake gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar. Përderisa, çmimi i kontratës së vitit 2019 ishte 33.80 euro, komuna nuk është dashur që për tenderin e vitit 2020 të parashikojë çmimin prej 34.67 euro. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar, siç duket komuna fare nuk ka marrë parasysh çmimin e kontratës paraprake dhe çmimet për kontrata të njëjta nga autoritetet tjera kontraktuese. Përcaktimi i saktë i vlerës së parashikuar të tenderit është një nga hapat e parë para se të publikohet një tender. Këtij hapi duhet t'i kushtohet shumë vëmendje, pasi një parashikim i fryrë i çmimit të një produkti bën që të paguhet më shumë sesa që duhet. Në kërkesat e dosjes së tenderit, komuna ka kërkuar të dorëzohet plani dinamik. Kjo kërkesë është e panevojshme kur merret parasysh se tenderi është kontratë kornizë ku autoriteti kontraktues bën porosi sa herë që të ketë nevojë për dru. Kërkesa për dorëzim të druve është përfshirë në kushtet e veçanta, ku thuhet se kompania ka në dispozicion 10 ditë pas marrjes së porosisë për t'i dërguar drutë. Përndryshe Aome Sh.P.K nuk ka dorëzuar plan dinamik, por një deklaratë ku është zotuar se furnizimi do të bëhet brenda 30 ditëve të punës. Planin dinamik dhe deklaratat për liferim nuk ka kuptim të njëjtë dhe duke marrë parasysh se afati i dhënë nga Aome Sh.P.K është më i gjatë se kërkesa në KV, atëherë mund të thuhet se Aome Sh.P.K nuk ka dorëzuar tenderin sipas kriterëve të dosjes së tenderit dhe do të duhej të cilësohej si ofertë e papërgjegjshme. Në mënyrë që të evitohen paqartësitë, në dosje të tenderit duhet të bëhet dallim i qartë në mes të një plani dinamik dhe një deklarate të liferimit.



NË TENDERIN PËR FURNIZIM ME DRU KANË OFERTUAR DY KOMPANI, AOME SH.P.K ME ÇMIM 30,750 EURO DHE WOOD COMPANY SH.P.K ME ÇMIM 25,237.50 EURO. FITUES ËSHTË ZGJEDHUR AOME SH.P.K, NDËRSA WOOD COMPANY ISHTË ELIMINUAR PËR SHKAK QË NUK KISHTË DORËZUAR LIBREZAT E QARKULLIMIT ME VALIDITET PËR NJËRIN KAMION.

Gjatë implementimit të kontratës komuna nuk ka respektuar hapat që kërkohen në bazë të Rregullës Financiare 01/2013. Komuna ka pranuar mallin dhe pastaj ka dërguar porositë te operatori ekonomik, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta, së pari të bëhet porosia përmes urdhërblerjeve e pastaj të pranohet malli. Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22 thotë që së pari duhet të bëhet kërkesa për blerje, pastaj urdhërblerja, hapi i tretë është raporti i pranimi e në hapin e katërt është pranimi i faturës. Pas pranimi të faturës mund të bëhet pagesa²⁵. Komuna ka pranuar furnizimin me dru në datat 18 dhe 19 shtator 2020, ndërsa ka dërguar urdhërblerjen më 30 shtator 2020. Komuna nuk ka mundësi në këtë mënyrë që të masë afatin e furnizimit të druve që sipas kontratës është 10 ditë pas marrjes së porosisë.

24 Neni 26.8, faqe 65, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, KRPP, 2019 <https://dpl.us/rruopp>

25 Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10203>

Furnizim me mekanizëm bujqësor dhe multi-kultivatora për subvencionim të fermerëve

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar dy kompani, Haxhijaha me çmim të peshuar prej 2,098.90 euro dhe Agri Bau me çmim të peshuar prej 3,033 euro. Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 70,000 euro dhe procedura e përdorur kishte qenë ajo me çmim të peshuar²⁶. Përdorimi i kësaj procedure kur mund të dihen sasisë është i ndaluar. Përdorimi i procedurës me poentim mund të shkaktojë pasiguri te ofertuesit pasi nuk mund t’i dinë paraprakisht sasisë që do të porositen, ndërsa rreziku është që një operator ekonomik të ketë informata për sasisë që do të porositen dhe të japë çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak. Pasi tenderi është furnizim, autoriteti kontraktues ka mundur ta dijë saktë sasinë e produkteve që do të porositen. Për më tepër, komuna ka mundur të përdorë procedurën e kontratës kornizë, në mënyrë që të ketë mundësi që sasia për një artikull të porositet plus/minus 30%. Përdorimi i çmimit të peshuar nuk e ka këtë mundësi dhe si e tillë lë hapësirë për keqpërdorime.

Komuna, përkatësisht njësia e kërkesës ka bërë një gabim gjatë hartimit të paramasës. Në dy vende në fajllin në Excel ka shkruar formula që nuk llogarisin të gjitha pozicionet në paramasë. Për shembull, në kategorinë B janë tri pozicione, mirëpo në kutinë që llogaritë totalin për kategorinë B është shënuar formula për të llogaritur vetëm dy pozicione. Njëjtë ka ndodhur edhe në kategorinë C, ku janë katër pozicione, mirëpo formula është shënuar që të llogarisë pozicionet e kategorisë A. Fatmirësisht të dy kompanitë i kanë vërejtur këto gabime dhe i kanë korrigjuar ato. Gabimet në paramasë kanë shumë ndikim, pasi një gabim në formula, mund të vë në lajthitje operatorët ekonomikë dhe çmimi të mos jetë në përputhje me sasisë e kërkuara. Po mos ta vërenin këtë ga-

bim operatorët ekonomikë, atëherë me siguri që tenderi do të anulohet për shkak se gabimet në paramasë nuk mund të përmirësohen pas dorëzimit të ofertave. Nëse një gjë e tillë do të ndodhte, komuna do të humbiste shumë kohë, për shkak se tenderi do të duhej të rishpallej.

Veprimet pozitive të komunës kanë të bëjnë me kushtet e veçanta, të cilat janë specifikuar edhe në dosje të tenderit, e jo vetëm pasi është nënshkruar kontrata. Me këtë ofertuesit e kanë pasur të qartë, afatin e liferimit të produkteve dhe garancionin.

Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët lokale në Komunën e Novobërdës

Ky aktivitet i prokurimit është tenderi i dytë për ndriçim publik që është monitoruar në Komunën e Novobërdës. Tenderi i parë është analizuar në raportin e parë të monitorimit²⁷, ku të gjeturat kryesore ishin se, për shkak që komuna ka përdorur procedurën e çmimit për njësi, gjatë implementimit të kontratës janë porositur produkte ku është dhënë çmim i lartë dhe janë porositur shumë pak produkte, ku çmimi ka qenë jonormalisht i ulët. Gjatë takimeve që D+ ka pasur me zyrtarët e komunës, këta të fundit janë zotuar që gabimet e bëra në tenderin e parë nuk do të përsëriten. Komuna ka marrë parasysh vërejtjet nga raporti i parë dhe paramasën e ka ndërtuar me sasi të parashikuar për secilin produkt.

Vlera e parashikuar për këtë tender ka qenë 55,000 euro, ndërsa fitues i kontratës ishte zgjedhur kompania Anesi, me çmim 32,156.75 euro, e cila njëkohësisht ka edhe çmimin më të ulët. Një kompani tjetër ishte cilësuar si e papërgjegjshme, ndërsa të tjerat kanë pasur çmime më të lartë.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Anesi Sh.P.K	32,156.75
2.	Monting Sh.P.K	34,188.10
3.	NSHP Elektra	35,237.90
4.	Labinot M. Krasniqi B.I	35,950.40
5.	ERPoëer Sh.P.K	36,460.80
6.	NSh M.V.R. Elektromontues	36,728.00
7.	Multi Business Group Sh.P.K	37,267.20
8.	Dar Ing Sh.P.K & Cimi @ Electronic Sh.P.K	38,000.00
9.	BM Group Sh.P.K	40,150.50
10.	Termomontimi	40,837.40

Tabela 8: Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët lokale në Komunën e Novobërdës”

Komuna nuk ka pasur shumë kritere në dosje të tenderit. Mirëpo, njëri nga kriteret që nuk është kërkuar si duhet është ai që OE-të të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar së paku tri projekte të ngjashme të realizuara brenda tri viteve të fundit (2017, ‘18, ‘19). Kërkesa do të duhej të ishte që projektet të jenë të realizuara për tri vitet e kaluara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë që ka qenë më 07.10.2020. Sipas interpretimit nga KRPP-ja²⁸ periodha trevjeçare duhet të përfshijë vitin vijues, do të thotë vitin në të cilin është publikuar njoftimi për kontratë dhe në rastin e këtij tenderi periodha 2018 – 2020.

Tjetër gabim është se, komuna, tenderin nuk e ka ndarë në lloje, por paramasën e ka ndarë në lloje, ku secili ndërtim i ndriçimit me një lokacion është llot në vete. Për secilin llot pozicionet janë pothuajse të njëjta, mirëpo jo edhe çmimet e dhëna nga kompania fituese. Për shembull në pozicionin që ka të bëjë për furnizim dhe montim të shtyllës elektrike, në 10 lloje çmimi është 100 euro për shtyllë, mirëpo në tri lloje tjera çmimi është 110 euro. Komuna është dashur të kërkojë sqarime nga kompania se përse për produktin me përshkrim të njëjtë ka vendosur dy çmime të ndryshme.

26 Çmimi i peshuar nënkupton që artikujt grupohen në kategori të caktuara dhe secilës prej tyre i jepet një peshë e caktuar, që në total është 100%. Shembull, nëse një ofertues ka dhënë çmimin prej 100 euro për një grumbull të artikujve, i cili e ka peshën 30%, atëherë çmimi i peshuar do të ishte 30 euro (100 * 0.3). Çmimi i peshuar shërben vetëm për të zgjedhur fituesin, mirëpo kontrata lidhet me çmimet për artikuj që ka dhënë kompania.

27 Komuna të vogla, probleme të mëdha. Demokraci Plus, 2020. <https://dplus.org/ep-content/uploads/2020/07/2020-07-Komuna-te-vogla-probleme-te-medha-ne-prokurim-ALB.pdf>

28 Pyetjet e shpeshta, nr. 57, KRPP, 2017. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=268>

Rekomandime

Për Komunën e Graçanicës:

- Të përdoret procedura e duhur për aktivitetet e prokurimit;
- Siguria e ekzekutimit të kërkohet në përputhje me ligjin, pra një vlerë prej 10% të çmimit të kontratës për një periudhë +30 ditë nga data e planifikuar e përfundimit të kontratës;
- Siguria e tenderit të llogaritet 1 deri 3% të vlerës së parashikuar ose minimumi 1,000 euro;
- Të vlerësohen ofertat sipas kërkesave të dosjes së tenderit;
- Të sigurohet se shuma e avansit nuk është më e lartë se siguria e ekzekutimit dhe të kërkohet edhe sigurimi i avansit;
- Të mos i eliminohen kompanitë të cilave ju është shkëputur kontrata, pasi nuk ka bazë ligjore të bëhet një gjë e tillë;
- Aktivitetet të planifikohen dhe të publikohen në planin e prokurimit.

Për Komunën e Mamushës:

- Të mos kërkohet plan dinamik për kontrata të furnizimeve dhe sidomos kur ka produkte të zakonshme;
- Të mos kërkohen referenca për tenderë të furnizimeve, ku produktet që kërkohen nuk prodhohen nga ofertuesit;
- Kur të kërkohen katalogje dhe broshura si kriter, të njëjtat duhet të pranohen vetëm nga prodhuesi e jo ato që shkruhen nga vetë ofertuesi.

Për Komunën e Shtërpcës:

- Të përdoren njësitë e duhura matëse në paramasë;
- Të vlerësohen ofertat sipas kërkesave të dosjes së tenderit;
- Kontratat të publikohen së bashku me pjesën financiare;
- T'i specifikohen kushtet e veçanta së bashku me dosjen e tenderit, e jo pasi të nënshkruhet kontrata;
- Të verifikohen çmimet në paramasë, përfshirë normën e TVSh-së;
- Të mos kufizohet konkurrenca me kërkesa të cilat mund t'ju përshtaten vetëm një ose disa OE-ve;
- Të mos kërkohen ISO Standarde dhe certifikata që aplikojnë standarde të vendeve të caktuara.

Për Komunën e Novobërdës:

- Paramasat të përmbajnë formula të sakta në excel, që të mos vendosë në lajthitje operatorët ekonomikë;
- Ofertat të vlerësohen sipas kriterëve të vendosura në dosje të tenderit;
- Procedura me poentim të çmimeve të përdoret vetëm atëherë kur komuna nuk e dinë sasinë e artikujve që do të porositen;
- Për OE-të që nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuar para nënshkrimit të kontratës të iniciohet procedura për diskualifikimin e tyre në përputhje me nenin 26.8 të RrUOPP-së;
- Kërkesa për projekte të realizuara në tri vitet e fundit të formulohet në atë mënyrë që të përfshijë tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.
- Pagesat të bëhen sipas Rregullës Financiare 01/2013.



Norwegian Embassy



KOSOVA CIVIL SOCIETY FOUNDATION
FONDACIONI KOSOVA PER SHQIPTARE CIVIL